




*Liberté • Égalité • Fraternité*

RÉPUBLIQUE FRANÇAISE

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
Drejtoria e përgjithshme e të huajve në Francë



# Udhërrëfyesi i azilkërkuesit

uAK<sup>nëntor</sup>2015



## PËRMBAJTJA

1. Format e ndryshme të mbrojtjes .....	4
<b>1.1. Statusi i refugjatit .....</b>	<b>4</b>
<b>1.2. Mbrojtja e dorës së dytë .....</b>	<b>4</b>
<b>1.3. Statusi i personit pa shtetësi.....</b>	<b>4</b>
2. Qasja në procedurë dhe e drejta e qëndrimit në territorin francez .....	6
<b>2.1. Përcaktimi i shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit .....</b>	<b>6</b>
<b>2.2. E drejta e qëndrimit në territorin francez.....</b>	<b>7</b>
3. Kushtet e shqyrtimit të kërkesës së azilit.....	9
<b>3.1. Shqyrtimi nga Zyra franceze e mbrojtjes së refugjatëve dhe personave pa shtetësi (OFPRA) 9</b>	<b>9</b>
■ Formulari i OFPRA-s që duhet plotësuar .....	9
■ Dërgimi i dosjes .....	9
■ Dëshmia e regjistrimit të kërkesës nga OFPRA.....	10
■ Shqyrtimi i kërkesës me procedurë normale ose me procedurë të përshpejtuar .....	10
■ Intervista në OFPRA.....	10
■ Vendimi i OFPRA-s.....	11
<b>3.2. Shqyrtimi nga Gjykata kombëtare e të drejtës së azilit (CNDA) .....</b>	<b>12</b>
■ Afatet e ankimit .....	12
■ Ankesa .....	12
■ Dëshmia e pranimit të ankesës .....	13
■ Ndihma nga avokati.....	13
■ Marrja në pyetje në CNDA.....	14
■ Vendimi i CNDA .....	14
<b>3.3. Papranueshmëria dhe mbyllja e kërkesës së azilit .....</b>	<b>15</b>
■ Kërkesa e papranueshme .....	15
■ Mbyllja e shqyrtimit të një kërkesë .....	15
<b>3.4. Rishqyrtimi .....</b>	<b>16</b>
4. Rrugëtimi i azilkërkuesit .....	17
<b>4.1. Shoqërimi i azilkërkuesit .....</b>	<b>17</b>
■ Pritja fillestare dhe orientimi.....	17
■ Kushtet materiale të pritjes.....	18
■ Marrja parasysh e prekshmërisë nga ana e sportelit të vetëm.....	19
<b>4.2. Strehimi i azilkërkuesit .....</b>	<b>19</b>
■ Vendet e strehimit.....	19
■ Orientimi drejt strehimit .....	20
■ Largimi nga vendi i strehimit .....	20
5. Të drejtat e azilkërkuesve.....	22
<b>5.1. Ndihma financiare për azilkërkues (ADA).....</b>	<b>22</b>
■ Kushtet për të përfituar nga ndihma.....	22
■ Hartimi i kërkesës .....	22
■ Shuma e ndihmës financiare .....	23





■ Derdhja e pagesës .....	23
■ Ankesa .....	23
<b>5.2. Qasja në shkollim .....</b>	<b>23</b>
<b>5.3. Qasja në shërbimet shëndetësore.....</b>	<b>24</b>
■ Shërbimet shëndetësore të urgjencës .....	24
■ Mbrojtja shëndetësore universale (CMU) .....	24
<b>5.4. Qasja në tregun e punës .....</b>	<b>24</b>
<b>6. Pasojat e refuzimit të kërkesës së azilit mbi të drejtën e qëndrimit në territorin francez .....</b>	<b>26</b>
<b>6.1. Vendimi i refuzimit nga OFPRA ose nga CNDA .....</b>	<b>26</b>
<b>6.2. Ndihma gjatë kthimit në vendin e prejardhjes.....</b>	<b>26</b>
<b>6.3. Kthimi i detyruar në vendin e prejardhjes .....</b>	<b>27</b>
<b>7. Të drejtat e përfituesve nga mbrojtja .....</b>	<b>28</b>
<b>7.1. Qëndrimi në Francë.....</b>	<b>28</b>
<b>7.2. Qëndrimi i familjes.....</b>	<b>29</b>
■ E drejta e qëndrimit e anëtarëve të familjes .....	29
■ E drejta e ribashkimit familjar .....	30
<b>7.3. Integrimi.....</b>	<b>30</b>
■ Nënshkrimi i kontratës së pranimit dhe integrit me Zyrën franceze të imigracionit dhe integritit (OFII) .....	30
<b>7.4. Të drejtat sociale.....</b>	<b>31</b>
■ Qasja në strehim.....	31
■ Qasja në tregun e punës.....	31
■ Qasja në shëndetësi .....	32
■ Shërbimet sociale dhe familjare .....	32
<b>7.5. Udhëtimi jashtë Francës .....</b>	<b>32</b>
<b>7.6. Natyralizimi .....</b>	<b>33</b>
<b>SHTOJÇË : adresa të dobishme .....</b>	<b>34</b>
<b>1. Adresa në shkallë vendi.....</b>	<b>34</b>
■ Shoqata.....	34
<b>2. Adresa vendore .....</b>	<b>36</b>
■ Sportele të vetme (unike).....	36
■ Prefektura .....	37
■ Drejtori territoriale të Zyrës franceze të imigracionit dhe integritit (OFII) .....	39





## 1. Format e ndryshme të mbrojtjes

---

Në Francë ekzistojnë tri forma mbrojtjeje : statusi i refugjatit, mbrojtja e dorës së dytë dhe statusi i personit pa shtetësi.

### 1.1. Statusi i refugjatit

Statusi i refugjatit mund t'ju jepet mbi këto tri baza :

- **Konventa e Gjenevës** lidhur me statusin e refugjatit, e datës 28 korrik 1951. Statusi i refugjatit i jepet « çdo personi i cili (...) duke u frikësuar me të drejtë nga persekutimi për shkak të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë ndaj një grupi shoqëror apo për shkak të opinioneve të veta politike, ndodhet jashtë vendit shtetas i të cilit është dhe nga i cili nuk mundet ose, për shkak të frikës së lartpërmendur, nuk dëshiron të kërkojë mbrojtje » ;
- **Azili i quajtur « kushtetues »**, buron nga paragrafi 4 i preambulës së Kushtetutës së vitit 1946. Statusi i refugjatit i jepet « çdo personi të persekutuar përs shkak të veprimtarisë së tij për liri » ;
- **Mandati i Komisariatit të lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët (HCR)** : nëse HCR ju ka njohur si refugjat në bazë të neneve 6 dhe 7 të statutit të tij.

### 1.2. Mbrojtja e dorës së dytë

Përfitimi i mbrojtjes së dorës së dytë i jepet çdo personi që nuk i përmbush kushtet për t'u njohur si refugjat, por kur ekzistojnë arsye serioze dhe të vërtetuara për të besuar se atij do t'i kanosej rreziku i vërtetë në vendin e vet nga njëri nga këto çënime të rënda :

- dënim me vdekje apo ekzekutim ;
- tortura apo ndëshkime ose trajtime çnjerëzore apo poshtëruese ;
- për një person civil, kërcënim i rëndë dhe individual ndaj jetës së tij ose ndaj personit të tij, për shkak të dhunës që mund të përhapet ndaj personave pa marrë parasysh gjendjen e tyre personale dhe si rezultat i një situatë konflikti të armatosur, qoftë ky i brendshëm apo ndërkombëtar.

Në Francë, statusi si refugjatit apo ai i mbrojtjes së dorës së dytë jepen nga Zyra franceze e mbrojtjes së refugjatëve dhe personave pa shtetësi (OFPRA), nën kontrollin e Gjykatës kombëtare të së drejtës së azilit (CNDA).

### 1.3. Statusi i personit pa shtetësi

Sipas Konventës së Nju Jorkut të datës 28 shtator 1954 mbi statusin e personave pa shtetësi, ky status mund t'i jepet çdo personi « që asnjë shtet nuk e konsideron si shtetas të vetin sipas legjislacionit të vet ». Ky status dallon nga të dyja format tjera të mbrojtjes dhe ka të bëjë vetëm me personat që nuk kanë shtetësi. Ai nuk i merr parasysh rreziqet nga persekutimi.

Statusi i personit pa shtetësi jepet nga OFPRA, nën kontrollin e gjykatës administrative.





Për dallim nga azilkërkuesi, i huaji që kërkon statusin e personit pa shtetësi nuk përfiton nga e drejta e qëndrimit mbi territorin francez gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës së tij.

Nuk duhet pra t'i drejtoheni prefekturës, por t'i shkruani drejtpërsëdrejti OFPRA-s, duke e treguar emrin, mbiemrin dhe adresën, si dhe arsyet që ju shtyjnë të bëni një kërkesë të tillë.

OFPRA du t'ju dërgojë një formular për kërkesë të statusit të personit pa shtetësi. Ju duhet ta plotësoni dhe t'i sqaroni rrethanat që çojnë të mendoni se nuk mund të merrni shtetësinë e asnjë shteti. Duhet të nënshkruani formularin dhe t'i bashkangjisni dy fotografi identiteti të kohëve të fundit dhe, nëse keni, dokumentin e udhëtimit, dokumentat e gjendjes civile dhe kopjen e lejes së qëndrimit të vlefshme.

Formulari në OFPRA duhet dërguar me postë me « letër të porositur me njoftim marrjeje » (« recommandé avec accusé de réception »).

OFPRA do t'ju thërrasë për një intervistë. Për dallim nga azilkërkuesi, ju nuk mund të shoqëroheni nga një avokat apo nga një përfaqësues i ndonjë shoqate.


Marrja juaj në pyetje do të zhvillohet në gjuhën që do të zgjidhni ju, përveç nëse mund të kuptoni ndonjë gjuhë tjetër në të cilën të komunikoni qartësisht.

OFPRA do t'ju informojë mbi vendimin e vet me postë, me « letër të porositur me njoftim marrjeje ».

- ✓ **Nëse OFPRA ju njeh statusin e personit pa shtetësi**, ju do të përfitoni nga të njëjtat drejta si përfituesit e tjerë të mbrojtjes (shih 7. Të drejtat e përfituesve të mbrojtjes), veçanërisht nga e drejta për leje qëndrimi, për dokument udhëtimi dhe nga ajo për të pasur një jetë normale në familje.
- ✓ **Nëse OFPRA refuzon t'ju njohë statusin e personit pa shtetësi**, ju mund të kontestoni këtë vendim pranë gjykatës administrative të vendit tuaj të qëndrimit në një afat prej dy muaj nga data e njoftimit të vendimit të OFPRA-s.

Kjo ankesë nuk ka veprim pezullues, që do të thotë se mund t'i nënshtroheni një procedure dëbimi (detyrim largimi nga territori francez) që mund të zbatohet pa pritur vendimin e gjykatës administrative.





## 2. Qasja në procedurë dhe e drejta e qëndrimit në territorin francez

---

Nëse dëshironi të kërkonti azil në Francë, ju duhet të parashtroni kërkesë azili pranë Zyrës franceze të mbrojtjes së refugjatëve dhe personave pa shtetësi (OFPRA).

Ju mund të kërkonti azil nëse jeni në qëndrim të rregullt në Francë. Azil mund të kërkonti edhe nëse jeni me qëndrim të parregullt për sa i përket lejes së qëndrimit dhe nëse keni hyrë në Francë në mënyrë të parregullt.

Nëse keni hyrë në Francë me vizë, është megjithatë e këshillueshme që kërkesën ta bëni para kalimit të afatit të vizës.

Që të mund të parashtroni kërkesën tuaj të azilit pranë OFPRA-s, ju duhet së pari të regjistroheni pranë sportelit të vetëm të pranimit të azilkërkuesve, nën varësinë e të cilit jeni (shih 4. Rrugëtimi i azilkërkuesit).

Në një kohë të parë, një punonjës i prefekturës i bën të vlefshme të gjitha informacionet e përcjella në sportelin e vetëm.

Në një kohë të dytë, një punonjës i Zyrës franceze të imigracionit dhe intergrimit (OFII) bën vlerësimin e gjendjes suaj personale.

Që nga momenti kur i përmbushni kushtet, ju jepet një dëshmi e kërimit të azilit, që është e vlefshme një muaj, dhe që ju mundëson të qëndroni në territorin francez.


### 2.1. Përcaktimi i shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit

Për të përcaktuar nëse shqyrtimi i kërkesës suaj të azilit është në përgjegjësinë e Francës, gjatë dorëzimit të dosjes suaj, një punonjës i prefekturës jua merr shenjat e 10 gishtërinjve dhe fillon një intervistë që ka për qëllim ripërshkrimin e rrugëtimit tuaj nga vendi juaj i prejardhjes, dhe të përcaktojë lidhjet eventuale, familjare për shembull, që mund t'i keni në vendet tjera anëtare. Mbi bazën e këtyre elementëve, do të përcaktohet vendi përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit, në zbatim të rregullores n°604/2013 të Parlamentit europian dhe të Këshillit nga data 26 qershor 2013, të quajtur rregullorja « Dublin III ».

#### Shtetet që kanë të bëjnë me mekanizmin « Dublin III »

Bëhet fjalë për 28 anëtarët e Bashkimit europian dhe 4 vende shoqëruese : Gjermania, Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Danimarka\*, Spanja, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Republika Çeke, Rumania, Mbretëria e Bashkuar, Sllovakia, Sllovenia dhe Suedia por gjithashtu në cilësinë e vendeve shoqëruese : Islanda, Norvegjia, Zvicra dhe Lichtensteini.

\* Danimarka nuk i nënshtrohet Rregullores "Dublin III", por vazhdon të zbatojë Konventën e Dublinit, të nënshkruar më 15 qershor 1990.

**Në fakt, është e mundur që jo Franca por një tjetër shtet europian të jetë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit, për shembull :**

- nëse një tjetër shtet anëtar ju ka dhënë leje qëndrimi apo vizë që është akoma e vlefshme ;
- nëse vërtetohet që keni kaluar në menyrë të parregullt kufirin e jashtëm tokësor, ajror apo detar të një shteti tjetër anëtar ;
- nëse keni hyrë në territorin e Bashkimit europian duke i kalur së pari kufijtë e një shteti anëtar për të cilin nuk ju duhet vizë ;
- nëse keni kërkuar tanimë azil në një tjetër shtet anëtar.

**Marrja përsipër nga një tjetër shtet anëtar :** nëse ndodh që një tjetër shtet anëtar, e jo Franca, të jetë përgjegjës për trajtimin e kërkesës suaj të azilit, atëherë prefektura do t'i fillojë përçapjet pranë atij shteti për t'i kërkuar marrjen tuaj përsipër.

Në atë rast do t'ju lëshohet një dëshmi e kërkesës së azilit, që ju jep të drejtën të qëndroni në territorin francez deri sa të kaloni në shtetin tjetër i cili të ketë pranuar përgjegjësinë e tij.

Kjo transfertë do të organizohet nga shërbimet e prefekturës të cilat do t'ju bëjnë me dije një vendim transferte i cili do të saktësojë mënyrën e nisjes suaj. Do të keni një afat prej 15 ditësh për të kontestuar këtë vendim pranë gjykatës administrative.

**Marrja përsipër nga Franca :** në rast se procedura e Dublinit do të nxirte në pah Francën si vend përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj, procedura do të zhvillohej sipas kushteve të përshkruara me poshtë (shih 2.2).

## 2.2. E drejta e qëndrimit në territorin francez

Kur shqyrtimi i kërkesës suaj është në përgjegjësinë e Francës, do t'ju jepet një dëshmi e parë kërkesës së azilit e vlefshme një muaj. Prefektura mund të refuzojë t'ju lëshojë këtë dëshmi në rastet e mëposhtme :

- nëse parashtroni kërkesë të re rishqyrtimi (shih 3.4.) ;
- nëse kundrejt jush ka një vendim përfundimtar i ekstradimit drejt një vendi tjetër, që s'është vendi juaj i prejardhjes, një vendim dorëzimi mbi bazë të një fletëarresti europian, apo një kërkesë dorëzimi nga një Gjykatë penale ndërkombëtare.

Përgjatë këtij afati njëmuajor, ju duhet të dorëzoni ose të dërgoni në OFPRA formularin e kërkesës së azilit brenda 21 ditësh (shih 3. Kushtet e shqyrtimit të kërkesës së azilit).

Nëse dosja juaj është e plotë, OFPRA ju dërgon një dëshmi pranimit me letër. Këtë letër duhet t'ia tregoni prefekturës së vendbanimit tuaj për të përtëritur dëshminë e kërkesës së azilit.

Dëshmia përtërihet përgjatë gjithë kohës së shqyrtimit të kërkesës suaj të azilit, deri në njoftimin e vendimit të OFPRA-s ose, në rast ankese pranë Gjykatës kombëtare të të drejtës së azilit (CNDA), pasi të keni paraqitur dëshminë e pranimit të ankesës (shih 3.2 Shqyrtimi nga ana e Gjykatës kombëtare të të drejtës së azilit), deri në njoftimin e vendimit të saj.

Gjatë çdo kërkesë për përtëritje, duhet që asaj t'i bashkangjisni dokumentat e kërkuara nga prefektura, sidomos dëshminë mbi vendbanimin apo vendstrehimin, ose adresën e organizatës që ka lidhur marrëveshje dhe që ju strehon.

Gjatë përtëritjes së parë, dëshmia e dytë është e vlefshme nëntë muaj në procedurë normale dhe gjashtë muaj në procedurë të përshpejtuar.



Gjatë përtritjes së rradhës, dëshmia është e vlefshme gjashtë muaj në procedurë normale dhe tre muaj në procedurë të përshpejtuar.

Kur shqyrtimi i kërkesës suaj të jetë në përgjegjësinë e një shteti tjetër të Bashkimit europian, dhe kur procedura e Dublinit është vënë në zbatim, vlefshmëria e dëshmisë së parë është një muaj. Ajo përtërihet për një kohëzgjatje prej katër muajsh (shih 2.1 Përcaktimi i shtetit përgjegjës për kërkesën tuaj të azilit).

**KUJDES** : Dëshmia e kërkesës së azilit nuk ju mundëson qarkullimin e lirë në vendet tjera të Bashkimit europian.

Prefektura mund t'jua tërheqë ose të refuzojë përtritjen e dëshmisë suaj të kërkesës së azilit në rastet e mëposhtme :

- Kur OFPRA ka shpallur kërkesën tuaj të papranueshme (shih 3.3. Papranueshmëria dhe mbyllja) ;
- Kur e keni informuar OFPRA-n mbi tërheqjen e kërkesës suaj të azilit (shih 3.3. Papranueshmëria dhe mbyllja) ;
- Kur OFPRA të ketë marrë vendim mbi mbylljen e çështjes dhe kur ju nuk keni kërkuar rihapjen e dosjes suaj (shih 3.3.) ;
- Kur keni parashtruar kërkesë rishqyrtimi, ndaj të cilës është marrë një vendim papranueshmërie, me të vetmin qëllim të shmangni një masë dëbimi (shih 3.4. Rishqyrtimi) ;
- Kur parashtroni kërkesë të re të rishqyrtimit (shih 3.4.) ;
- Kur kundrejt jush ka ndonjë vendim përfundimtar ekstradimi drejt një vendi tjetër, që s'është vendi juaj i prejardhjes, ose një vendim dorëzimi mbi bazën e një fletëarresti europian, apo një kërkesë dorëzimi nga një Gjykatë penale ndërkombëtare.

Në këtë rast, duhet të lini territorin francez, përndryshe ndaj jush të shqiptohet një urdhër për të lënë territorin francez.







## 3. Kushtet e shqyrtimit të kërkesës së azilit

### 3.1. Shqyrtimi nga Zyra franceze e mbrojtjes së refugjatëve dhe personave pa shtetësi (OFPRA)

Në të njëjtën kohë me dëshminë e kërkesës së azilit, prefektura ju ka dorëzuar një formular për kërkesë azili që duhet ta plotësoni dhe t'ia dërgoni OFPRA-s.

Gjatë dorëzimit të kërkesës suaj të azilit, nuk keni nevojë të saktësoni nga i cili lloj i mbrojtjes dëshironi të përfitoni (statusi i refugjatit apo mbrojtja e dorës së dytë). Bëhet fjalë për të njëjtën procedurë gjatë së cilës kërkesa juaj do të shqyrtohet nga OFPRA, së pari nga këndvështrimi i statusit të refugjatit, dhe pastaj, nëse situata juaj nuk i përgjigjet këtij statusi, nga këndvështrimi i mbrojtjes së dorës së dytë.

Nëse OFPRA nuk ju njeh statusin e refugjatit apo të drejtën e përfitimit nga mbrojtja e dorës së dytë, ju mund të ankoheni pranë CNDA (shih 3.2. Shqyrtimi i kërkesës së azilit nga Gjykata kombëtare e të drejtës së azilit). Ju mund gjithashtu të ankoheni pranë CNDA nëse dëshironi të kontestoni vendimin e OFPRA-s me të cilin ajo nuk ju jep të drejtën e mbrojtjes të dorës së dytë.

Informatat që i përmban kërkesa juaj e azilit janë të fshehta dhe në asnjë rast nuk i komunikohen autoriteteve të vendit tuaj të prejardhjes.

#### ■ Formulari i OFPRA-s që duhet plotësuar

**Formulari duhet të jetë i plotësuar në frëngjisht**, i nënshkruar dhe atij duhet t'i bashkangjitet fotokopja e dëshmisë së vlefshme të kërkesës së azilit, dy fotografi identiteti si dhe dokumenti i udhëtimit, nëse keni një të tillë. Këto dokumenta janë të domosdoshme që kërkesa juaj të regjistrohet nga OFPRA.

#### ■ Dërgimi i dosjes

Kur dosja juaj të jetë e plotë, **duhet ta dërgoni më së voni në ditën e 21-të** (me përjashtim të kërkesave për rishqyrtim) nga data e lëshimit të dëshmisë suaj të kërkesës së azilit, dhe vetëm me postë, në adresën e mëposhtme :

OFPRA  
201, rue Carnot  
94 136 FONTENAY-SOUS-BOIS CEDEX

Për shembull, nëse dëshmia juaj e kërkesës së azilit është lëshuar më 10 janar, ju duhet të keni dërguar dosjen tuaj në OFPRA jo më vonë se më 31 janar. Vula e postës shërben si dëshmi mbi datën.

Është thellësisht e këshillueshme që dosjen tuaj ta dërgoni me « letër të porositur me njoftim marrjeje », duke shënuar qartësisht emrin tuaj në pjesën « dërguesi ».



Nëse dosja juaj nuk është e plotë, OFPRA jua kthen dhe ju keni një afat plotësues prej tetë ditësh për ta plotësuar dhe dërguar përsëri. Nëse nuk e dërgoni përsëri dosjen tuaj brenda këtij afati, OFPRA e mbyll kërkesën tuaj dhe dëshmia juaj e kërkesës së azilit nuk do të përtërihet më.

Gjatë gjithë kohës së procedurës, në çdo çast, ju mund t'i dërgoni OFPRA-s elemente shtesë. Në atë rast, mos harroni që, në çdo leter të drejtuar OFPRA-s, të shënoni numrin tuaj të dosjes i cili figuron në letrën e regjistrimit të kërkesës suaj të azilit.

Në rast ndryshimi adrese, është e domosdoshme të informoni OFPRA-n sa më shpejt të jetë e mundur, me letër, më mirë me « letër të porositur me njoftim marrjeje ». Në fakt, OFPRA ju dërgon letra në adresën e fundit që ajo e ka të ditur, sidomos kur ju thërret për intervistë apo kur jua dërgon vendimin që ka marrë mbi kërkesën tuaj të azilit.

Ruani nga një kopje të të gjitha letrave që i dërgoni nga OFPRA e të pranuar nga ajo, si dhe dëshmitë e dërgimit dhe marrjes nga posta.

### ■ Dëshmia e regjistrimit të kërkesës nga OFPRA

Kur dosja juaj është e plotë dhe ka mbërritur me kohë, OFPRA ju dërgon një letër me të cilën ju informon se kërkesa juaj është regjistruar dhe ju komunikon numrin e dosjes suaj. Ky dokument përbën dëshminë zyrtare që kërkesa e juaj e azilit është regjistruar pranë OFPRA-s. Dhe është po ai që ju mundëson të përtërin dëshminë tuaj të parë të kërkesës së azilit.

### ■ Shqyrtimi i kërkesës me procedurë normale ose me procedurë të përshpejtuar

Kërkesa juaj e azilit shqyrtohet nga OFPRA, qoftë në procedurë normale, qoftë në procedurë të përshpejtuar.

Në procedurë të përshpejtuar, afatet e shqyrtimit shkurtohen në 15 ditë, por ju përfitoni nga të njëjtat garanci si në procedurë normale. OFPRA megjithatë ka gjithmonë të drejtën të kalojë prap dosjen tuaj me procedurë normale nëse ajo e vlerëson të nevojshme sipas dosjes suaj situatës suaj të veçantë.

Kërkesa juaj shqyrtohet nga OFPRA në procedurë të përshpejtuar kur ajo të jetë vendosur në procedurë të tillë qysh nga sporteli i vetëm (shih 4. Rrugëtimi i azilkërkuesit).

OFPRA mund gjithashtu të vendosë me procedurë të përshpejtuar në rastet e mëposhtme :

- nëse keni paraqitur dokumenta të rreme, keni dhënë indikacione të gabuara ose keni fshehur informata ose dokumenta me qëllim që OFPRA të ngatërrohet ;
- nëse keni paraqitur kërkesa tjera të azilit me identitete tjera ;
- nëse, duke e mbështetur kërkesën tuaj të azilit, keni ngritur çështje që s'kanë të bëjnë me nevojën për mbrojtje ;
- nëse deklaratat tuaja nuk janë të lidhura mirë, janë kundërthënëse, haptazi të rreme ose pak të besueshme dhe janë kundërthënëse ndaj asaj që Zyra e ka të ditur mbi vendin tuaj të prejardhjes.


Nëse dëshironi të kontestoni vënien tuaj në procedurë të përshpejtuar, këtë mund ta bëni vetëm gjatë ankesës pranë CNDA.

### ■ Intervista në OFPRA

Pasi kërkesa juaj të jetë regjistruar nga OFPRA, ju do të pranoni një fletëthirrje për intervistë.

Mund të liroheni nga intervista vetëm në dy raste :

- kur informacionet që i keni dorëzuar në dosjen tuaj janë të mjaftueshme që OFPRA t'ju njohë statusin e refugjatit ;



- kur arsye shëndetësore, të qëndrueshme dhe që s'varen nga vullneti juaj, ju pengojnë të paraqiteni dhe të jeni të pranishëm në intervistë.

Nëse jeni të thirrur për intervistë, duhet të shkoni në selinë e OFPRA-s, në Fontenay-sous-Bois. Aty do t'ju dëgjojë një punonjës i OFPRA-s i quajtur « oficer i mbrojtjes » dhe, në rast nevoje, në praninë e një përkthyesi që është në dispozicion të OFPRA-s dhe që flet gjuhën të cilën në formularin e kërkesës së azilit keni deklaruar se e flisni, ose që është e besueshme të mendohet se e flisni.

Nëse nuk paraqiteni në këtë takim, mosprania juaj mund të ketë pasoja negative mbi kërkesën tuaj të azilit, sidomos të çojë në mbylljen e dosjes suaj. Është pra e domosdoshme që, në rast pamundësie, të lajmeroni OFPRA-n të paktën 48 orë më herët, ose t'ia bëni me dije çdo vonesë.

Nëse doni, ju mund të paraqiteni në intervistë të shoqëruar qoftë nga një avokat, qoftë nga një përfaqësues i autorizuar i një shoqate të aftësuar nga OFPRA që do të mund të përpilojë shënime pas intervistës. Kjo e fundit megjithatë nuk do të shtyhet nëse avokati apo përfaqësuesi i shoqatës nuk janë të pranishëm në orën e caktuar në fletëthirrje.

Nëse, për arsye të vështirësive që t'i shpalosni motivet e kërkesës suaj, dëshironi që intervista të zhvillohet me një punonjës të zyrës dhe/ose me një përkthyes të gjinisë që do ta zgjidhni ju, ju mund t'ia bëni një kërkesë të tillë OFPRA-s.

Intervista është e fshehtë. Deklaratat tuaja do të figurojnë në një raport të përpiluar nga oficeri për mbrojtje me të cilin është zhvilluar intervista dhe i cili, nëse ju bëni një kërkesë të tillë, do t'ju komunikohet para se të merret vendimi (në procedurë normale) ose jo më vonë se në momentin kur e merrni vendimin (në procedurë të përshpejtuar).

Intervista gjithashtu inçizohet me zë, dhe ju mund të keni qasje në të vetëm në rast vendimit negativ nga OFPRA dhe në kuadër të një ankese kundër këtij vendimi.

#### ✓ Takimi me video-konferencë

Mund të ndodhë që takimi juaj, për arsye të largësisë suaj gjeografike (sidomos kur ndodheni në territoret përtej detit) ose të gjednjës suaj të veçantë (kur, për arsye shëndetësore ose familjare, nuk jeni në mundësi të lëvizni ose nëse mbaheni në një vend të privuar nga liria), të mos zhvillohet në Fontenay-sous-Bois, por në distancë, në saje të komunikimit audiovizuel. Në këtë rast, avokati ose përfaqësuesi i shoqatës e cila ju asiston do të jetë, në rast nevoje, pranë jush. Përkthyesi do të jetë pranë oficerit për mbrojtje.

Ekziston një degë e OFPRA-s në Basse-Terre (departamenti i Guadelupës), kompetente, për sa i takon kërkesave të azilit të dorëzuara në tre departamente franceze të Amerikës : Guadeloupe, Martinique dhe Guyane. Nëse keni dorëzuar kërkesë në njërin nga këto tre departamente, seanca juaj e dëgjimit do të mbahet drejtpërsëdrejti në Basse-Terre, qoftë me video-konferencë, qoftë në departamentin ku banoni në rast të një hetimi.

## ■ Vendimi i OFPRA-s

#### ✓ Afatet

Afatet për të marrë një vendim nga OFPRA janë të ndryshme : mesatarisht 15 ditë për një procedurë të përshpejtuar dhe deri në disa muaj në procedurë normale. Mospërgjigja e zgjatur e OFPRA-s nuk do të thotë që kërkesa juaj është refuzuar. Nëse OFPRA nuk mund të sjellë vendim në afat prej 6 muajsh, ajo do t'ju informojë me letër. Duhet pra që rregullisht të verifikoni postën tuaj.

#### ✓ Vendimi pozitiv

Nëse kërkesa juaj ka marrë një vendim pozitiv, ju :



- ose do të njiheni si refugjat, dhe OFPRA do t'ju përcjellë në atë rast vendimin mbi njohjen e statusit të refugjatit ;
- ose do t'ju njihet e drejta e mbrojtjes së dorës së dytë, dhe OFPRA do t'ju përcjellë vendimin mbi të drejtën e përfitimit nga mbrojtja e dorës së dytë.

#### ✓ **Vendimi negativ**

Nëse kërkesa juaj e azilit refuzohet, OFPRA do t'ju dërgojë vendimin e përpiluar në gjuhën frënge, si dhe një dokument, të përkthyer në një gjuhë për të cilën është e arsyeshme të mendohet se e kuptoni, duke ju vënë në dijeni që kërkesa juaj është refuzuar.

Ju do të mund ta kontestoni atë vendim pranë CNDA në një afat prej një muaji nga data kur ai ju është bërë me dije.

Nëse dëshironi të përfitoni nga një ndihmë juridike në përpilimin e ankesës suaj, duhet të bëni kërkesën në një afat prej 15 ditësh duke filluar nga data kur ju është bërë me dije vendimi mbi refuzimin, ose gjatë dorëzimit të ankesës.

Nëse nuk keni dorëzuar ankesë pranë CNDA në afat prej një muaji nga bërja me dije e vendimit mbi refuzimin nga OFPRA, e drejta juaj e qëndrimit në territorin francez merr fund dhe ju duhet të lini Francën.

## 3.2. Shqyrtimi nga Gjykata kombëtare e të drejtës së azilit (CNDA)

### ■ **Afatet e ankimit**

Ju keni në dispozicion një afat prej një muaji nga momenti kur ju është bërë me dije refuzimi nga OFPRA për të dorëzuar ankesën tuaj pranë CNDA. Ju mund të kërkonit qoftë të përfitoni nga një lloj mbrojtjeje në rast të një vendimi refuzues nga OFPRA, qoftë të kërkonit njohjen e cilësisë së refugjatit në rast të dhënies së mbrojtjes së dorës së dytë. Në këtë rast, nëse CNDA nuk ju njeh cilësinë e refugjatit, ajo nuk mund të trajtojë përsëri mbi dhënien e mbrojtjes së dorës së dytë nga ana e OFPRA-s.

Kjo ankesë duhet të arrijë në CNDA para kalimit të këtij afati prej një muaji (për shembull, nëse e merrni vendimin mbi refuzimin tuaj nga posta më 20 janar, ankesa juaj duhet të regjistrohet në CNDA jo më vonë se më 21 shkurt). Ankesa juaj duhet pra të jetë e dërguar para ditës së fundit të afatit prej një muaji. Sa i përket dërgimit të ankesës suaj, ju mund të zgjidhni nëse do ta dërgoni me letër të porositur me njoftim marrjeje, me letër të thjeshtë apo me faks. Nëse ky afat prej një muaji do të ketë kaluar në momentin kur gjykata e pranon ankesën tuaj, kjo e fundit do të shpallet e papranueshme, që do të thotë se do të hidhet poshtë pa seancë dëgjimi, dhe pa u shqyrtuar fare.

### ■ **Ankesa**

Duhet respektuar kushtet e mëposhtme :

- pikësëpari, lexoni mirë të gjitha sqarimet e shënuara nga ana e prapme e vendimit refuzues të OFPRA-s ;
- ankesa duhet të jetë e shkruar në gjuhën frënge në letër të thjeshtë (nuk ka formular të parashikuar për këtë gjë) mbi të cilën do t'i shënoni emrin, mbiemrin, gjendjen e plotë civile, profesionin dhe vendbanimin. Duhet të shënoni që bëhet fjalë për një ankesë dhe të përmendni numrin e dosjes nga OFPRA ;



- duhet me patjetër që ankesës suaj t'i bashkangjisni një kopje nga vendimi i OFPRA-s ;
- duhet të arsyetoni ankesën tuaj, që do të thotë të sqaroni pse nuk pajtoheni me arsyetimet e refuzimit të OFPRA-s ose me motivet që e kanë shtyrë OFPRA-n t'ju njohë të drejtën e përfitimit nga mbrojtja e dorës së dytë dhe jo statusin e refugjatit ;
- duhet t'ia bashkangjisni dokumentat që i keni e që dëshmojnë identitetin tuaj dhe shtetësinë tuaj ;
- duhet gjithashtu t'i bashkangjisni dokumentat që e plotësojnë rrëfimin tuaj ;
- duhet të tegoni në ankesën tuaj në cilën gjuhë dëshironi të zhvillohet seanca e dëgjimit, kur ajo të mbahet nga gjykata.

Për sa i përket dokumentave mbi shtetësinë tuaj, është e dëshirueshme t'i bashkangjisni një kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit, dhe t'i ruani origjinalet, nëse i keni, gjë që do t'ju mundësojë t'i tërhiqni nga posta letrat që do t'ju dërgohen me letër të porositur nga ana e gjykatës. Ju do të mund t'i paraqisni origjinalet ditën e seancës së dëgjimit, me kërkesë të prerë të trupit gjykues.

Sa i përket dokumentave që e vërtetojnë rrëfimin tuaj, është e pëlqyeshme që origjinalet t'ia shtoni dosjes ndërsa kopjet t'i ruani. Këto dokumenta do të mund t'ju kthehen ditën e marrjes në pyetje, nëse bëni një kërkesë të tillë, ose do t'ju dërgohen më tutje me postë. Dokumentat që e vërtetojnë rrëfimin tuaj duhet të jenë të përkthyer në frëngjisht. Pa përkthim, CNDA nuk do të mund t'i përdorë. Nuk është megjithatë e domosdoshme që përkthimi të bëhet nga një përkthyes i autorizuar, përveç kur bëhet fjalë për çertifikata të gjendjes civile si dhe për akte gjyqësore ose ato të lëshuara nga policia.

- Ju duhet të nënshkruani ankesën tuaj. Nëse jeni në moshë të mitur, është përfaqësuesi juaj ligjor ai që duhet ta nënshkruajë ;
- Ju duhet t'i ruani dëshmitë e dërgesës dhe dorëzimit të ankesës suaj, si dhe një kopje të saj ;
- Ju duhet të informoni CNDA mbi çdo ndryshim adrese ;
- Ju mund të kërkontë dhënien e dosjes suaj pas regjistrimit të ankesës suaj.

Nëse ankesa juaj i nënshtrohet një seance dëgjimore publike, ju do të thirrëni personalisht për këtë qëllim. Në këtë rast, ju do të mund të shtoni me shkrim informacione shtesë deri në një afat që do t'ju saktësohet në fletëthirrjen tuaj.

Nëse ankesa juaj nuk paraqet elemente serioze të cilat do të mund të vinin në dyshim vendimin e OFPRA-s, CNDA, pas shqyrtimit të dosjes suaj nga një raportues, mund të refuzojë ankesën tuaj me urdhër dhe pa ju thirrur në seancë dëgjimi.

### ■ Dëshmia e pranimit të ankesës


Pas regjistrimit të dosjes suaj, CNDA do t'ju dërgojë, në adresën që do t'ia keni bërë me dije, një dokument që quhet « dëshmi pranimi e ankesës ». Ky dokument vërteton se ankesa juaj është regjistruar. Ai ju mundëson të kërkontë përtëritjen e vërtetimit tuaj të kërkesës së azilit, meqenëse jeni të autorizuar të qëndroni në Francë deri sa CNDA të vendosë mbi kërkesën tuaj.

### ■ Ndhimja nga avokati

Ju e keni mundësinë të ndihmoheni nga një avokat gjatë marrjes suaj në pyetje në CNDA.

Ju mund të kërkontë të përfitoni nga ndihma juridike. Shpenzimet e avokatit merren atëherë plotësisht përsipër nga Shteti, dhe avokati pra nuk mund t'ju kërkojë honorare. Për të kërkuar ndihmën juridike ju duhet të parashtroni, qoftë një kërkesë për ndihmë juridike pranë zyrës së CNDA për ndihmë juridike, në një afat prej 15 ditësh nga vendimi refuzues i OFPRA, me qëllim të parashtrimit të ankesës, qoftë një kërkesë për ndihmë juridike jo më vonë se me rastin e ankimit tuaj.

Adresa e Zyrës për ndihmë juridike (BAJ) të CNDA :



Cour nationale du droit d'asile  
35, rue Cuvier  
93 558 MONTREUIL-SOUS-BOIS

Ju mund të tregoni emrin e një avokati që do të ketë pranuar t'i ofrojë shërbimet e tija për ndihmë juridike, ose t'i kërkoni CNDA që t'ju caktojë një të tillë. Nëse përfitonit nga ndihma juridike, në asnjë rast nuk duhet të paguani avokatin e caktuar, edhe nëse ai jua kërkën një gjë të tillë.

Kërkesa juaj për ndihmë juridike do të mund të hidhet poshtë vetëm nëse ankesa juaj duket qartësisht e papranueshme.

### ■ Marrja në pyetje në CNDA

CNDA do t'ju thërrasë për një seancë dëgjimi me qëllim shqyrtimin e kërkesës tuaj. Fletëthirrja do t'ju mbërrijë me letër, të paktën një muaj para datës së caktuar për seancë dëgjimore, përveç nëse ankesa juaj është në shqyrtim me procedurë të përshpejtuar, me ç'rast do të thirreni 15 ditë para marrjes në pyetje. Kjo e fundit do të zhvillohet në hapësirat e CNDA që gjenden në Montreuil ose me video-konferencë në departamentin përtej detit ku e keni bërë kërkesën tuaj.

Trupi gjyqësor i CNDA i cili e shqyrton ankesën tuaj drejtohet nga një magjistrat. Kjo nënkupton sidomos një personalitet të kualifikuar, të emëruar nga Komisariati i lartë i Kombeve të bashkuara për refugjatët (HCR). Trupi gjyqësor shprehet mbi ankesën tuaj, pasi të kenë dëgjuar raportuesin, i cili e analizon kërkesën tuaj të azilit, pa u futur në llojin e vendimit, në bazë të sqarimeve tuaja dhe të atyre të avokatit tuaj, nëse keni një të tillë.

Kur zyra të ketë shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar dhe kur të ketë vlerësuar se kërkesa juaj është e papranueshme, i takon një gjykatësi të vetëm të CNDA të vendosë mbi ankesën tuaj në një afat prej pesë javësh.

Me nismën e vet apo me kërkesë nga ana juaj, Gjykata mund gjithmonë të vendosë të shqyrtojë kërkesën në kolegji, nëse ajo vlerëson se kërkesa nuk bie në procedurë të përshpejtuar, nuk është e pranueshme, ose përfaqëson vështirësi serioze.

CNDA siguron praninë e një përkthyesi në gjuhën që ju e keni kërkuar ose, nëse nuk ka të tillë apo nëse kjo s'është e mundur, në gjuhën në cilën ju ka intervistuar OFPRA. Prania juaj në seancën dëgjimore është thellësisht e këshillueshme. Në rast të pamundësisë ose vonesës, duhet të paralajmëroni CNDA. Nëse nuk mund të paraqiteni në seancë dëgjimore, mund të kërkoni që ajo të shtyhet, duke sqaruar me shkrim arsyet për të cilat nuk mund të vini. Shtyrja nuk është e drejtë që e gëzoni, i takon vetëm presidentit të trupit gjyqësor pranë CNDA të vendosë mbi mundësinë e shtyerjes eventuale të marrjes suaj në pyetje për më tutje.

Marrja në pyetje është publike. Megjithatë ju mund t'i kërkoni presidentit të trupit gjyqësor të kërkojë seancë të mbyllur, që do të thotë që rasti juaj të shqyrtohet pa praninë e publikut. Në këtë rast, seanca e mbyllur do të pranohet automatikisht. Presidenti i trupit gjyqësor mund gjithashtu të vendosë një gjë të tillë.

### ■ Vendimi i CNDA

CNDA ju dërgon vendimin e vet në gjuhën frënge me « letër të porositur me njoftim marrjeje », dhe një dokument të përkthyer në një gjuhë për të cilën është e arsyeshme të mendohet se e kuptoni, duke ju treguar llojin e vendimit.

CNDA mund :



- të anulohet vendimi e refuzimit nga OFPRA dhe t'ju njohet cilësinë e refugjatit ose të drejtën e përfitimit nga mbrojtja e dorës së dytë. Atëherë ju do t'i gëzoni të njëjtat të drejta sikur t'ju ishte njohur njëra nga këto mbrojtje nga OFPRA ;
- të anulohet vendimi e OFPRA-s që ju jep të drejtën e mbrojtjes së dorës së dytë dhe të zëvendësojë atë me njohjen e cilësisë së refugjatit ;
- të konfirmojë vendimin refuzues të OFPRA-s dhe të hedhë poshtë ankesën tuaj ;
- të anulohet, në disa raste, vendimin e OFPRA-s dhe t'i kërkojë të rishqyrtojë kërkesën tuaj.

Vendimi i CNDA mund t'i nënshtrohet kërkesës për anulim vendimi, pranë Këshillit të Shtetit. Ky i fundit nuk e rishqyrton plotësisht kërkesën tuaj, por vetëm disa çështje juridike të saj. Kjo procedurë është e gjatë dhe kërkon një avokat të specializuar. Ju mund të kërkonit ndihmë juridike. Kjo ankesë nuk do të vazhdojë qëndrimin tuaj në Francë dhe nuk do të pengojë riatdhetësimin tuaj. Kur bëhet fjalë për këtë procedurë, është e dëshirueshme të merrni këshilla nga një shoqatë ose nga një avokat.

### 3.3. Papranueshmëria dhe mbyllja e kërkesës së azilit

#### ■ Kërkesa e papranueshme

OFPRA mund të vendosë që kërkesa është e papranueshme kur :

- ju përfitoni tanimë nga një mbrojtje efektive që ka të bëjë me azilin nga një shtet anëtar të Bashkimit evropian ;
- ju përfitoni nga statusi i refugjatit dhe një mbrojtje efektive në një shtet të tretë ku mund të jeni me të vërtetë i pranueshëm.

Ju mund të kontestoni këtë vendim pranë CNDA.

Në rast të shpalljes së papranueshmërisë së kërkesës suaj, ju nuk keni më të drejtë të qëndroni mbi territorin francez dhe duhet të lini Francën, edhe në rast se ankoheni pranë CNDA.

#### ■ Mbyllja e shqyrtimit të një kërkesë

##### ✓ Rasti i mbylljes

OFPRA mund të mbyllë kërkesën tuaj kur :

- ta keni informuar se e keni tërhequr kërkesën tuaj të azilit me rastin e intervistës ose me letër ;
- të mos e keni dorëzuar kërkesën tuaj në afatin e caktuar prej 21 ditësh ose të mos jeni paraqitur në intervistë ;
- të refuzoni qëllimisht t'i jepni të dhënat themelore mbi shqyrtimin e kërkesës suaj ;
- të mos mund t'ju kontaktojë, si pasojë e mosbërjes me dije të adresës suaj në një afat të arsyeshëm.

Në rast të mbylljes së kërkesës suaj, ju nuk do të përfitoni më nga e drejta e qëndrimit në territorin francez dhe duhet të lini Francën.

##### ✓ Rihapja

Në rast të mbylljes së shqyrtimit të kërkesës suaj, mund të kërkonit rihapjen e saj në një afat prej nëntë muajsh nga vendimi i mbylljes.

Për këtë, ju duhet të paraqiteni në prefekturë për t'u regjistruar përsëri.





Pastaj do të keni tetë ditë, duke filluar nga ky regjistrim në prefekturë, për të parashtruar kërkesën tuaj të rihapjes pranë OFPRA-s, e cila do të rihapë atëherë dosjen tuaj dhe do të rimarrë shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit, në po të njëjtën fazë ku ajo është ndërprerë.

Në rast të kërkesës për rihapje në afat prej nëntë muajsh, ju përfitonit përsëri nga e drejta e qëndrimit në territorin francez dhe do t'ju lëshohet një dëshmi e kërkesës së azilit.

Pasi të ketë kaluar afati prej nëntë muajsh, kërkesa juaj e rihapjes do të trajtohet si një kërkesë për rishqyrtim (shih 3.4. Rishqyrtimi).

### 3.4. Rishqyrtimi

Pas hedhjes poshtë të kërkesës suaj nga CNDA ose nëse nuk keni parashtruar ankesë në afat prej një muaji pasi ju është bërë me dije vendimi i OFPRA-s, ju mund t'i kërkonit kësaj të fundit të rishqyrtojë kërkesën tuaj, por vetëm nëse keni ndonjë « element të ri », i cili :

- mund të jetë i mëvonshëm ose i mëhershëm në krahasim me vendimin e CNDA, por të cilin e keni mësuar më vonë ;
- dhe të jetë i natyrës së tillë që të mund të arsyetojë frikën tuaj personale nga persekutimi dhe rreziqet ose kërcënimet e rënda në rast kthimi në vendin tuaj, e për të cilat keni folur.

Ju mund të kërkonit këshilla nga një shoqatë ose nga ndonjë avokat.

Ju duhet të paraqiteni në prefekturë që kërkesa juaj të regjistrohet.

Pastaj do të keni afat prej 8 ditësh duke filluar nga ky regjistrim i ri për të parashtruar ankesën tuaj të rishqyrtimit pranë OFPRA-s. Nëse kërkesa juaj nuk është e plotë, zyra do t'ju kërkojë ta plotësoni në një afat prej katër ditësh.

OFPRA pastaj do të bëjë shqyrtimin paraprak të kërkesës suaj dhe do të marrë një vendim mbi pranueshmërinë e saj në një afat prej tetë ditësh nga parashtrimi i saj. Gjatë këtij rishqyrtimi, jo domosdoshmërisht do të thirreni për intervistë.

Pas përfundimit të shqyrtimit, OFPRA mund ta shpallë të papranueshme kërkesën tuaj të rishqyrtimit nëse faktet apo elementet që i jepni nuk janë të një natyre të tillë që të mund të rrisin në mënyrë të rëndësishme mundësinë që të përfitonit nga mbrojtja.

Nëse OFPRA e shpall të papranueshme kërkesën tuaj, ajo do të trajtohet, përveç në rast të një vendimi të kundërt, në procedurë të përshtetshme.

Në rast të një kërkesë të parë rishqyrtimi, nëse prefektura vlerëson se kërkesa juaj është parashtruar me qëllimin e vetëm për të shmangur një masë dëbimi dhe nëse OFPRA e shpall të papranueshme, ju nuk do të përitoni më nga e drejta e qëndrimit në territorin francez duke filluar nga momenti i vendimit të OFPRA-s.

Në rast të një kërkesë të dytë rishqyrtimi, nuk përfitonit nga e drejta e qëndrimit.

Në të dyja rastet, dëshmia e kërkesës së azilit mund t'ju refuzohet ose mos t'ju përtërihet, dhe ndaj jush mund të ushtrohet një masë dëbimi, madje edhe në rast ankese pranë CNDA.





## 4. Rrugëtimi i azilkërkuesit

---

### 4.1. Shoqërimi i azilkërkuesit

#### ■ Pritja fillestare dhe orientimi

Për të parashtruar kërkesën tuaj pranë OFPRA-s, ju duhet paraprakisht të regjistroni kërkesën tuaj të azilit pranë një sporteli të vetëm (unik).

Sporteli i vetëm është i përbërë nga punonjës të prefekturës dhe nga ata të Zyrës franceze të imigracionit dhe intergrimit (OFII), të mbledhur bashkë posaçërisht për të siguruar pritjen tuaj.

Ekzistojnë 34 sportele të vetme të shpërndara në të gjithë territorin e Francës metropolitane (mund të konsultoni listën në shtojcë).

Nuk është e nevojshme të keni një adresë postare për regjistrimin e kërkesës suaj të azilit.

Para se të shkoni pranë sportelit të vetëm, ju duhet të paraqiteni pranë ndonjë shoqate që bën pritjen fillestare, e që merr përsipër t'ju shoqërojë në përçapjet tuaja. Këto të dhëna mund të merren pranë sportelit të përbashkët nga i cili vareni.

#### ✓ Shoqatat që kanë përsipër pritjen fillestare

Shoqatat që kanë përsipër pritjen fillestare kanë për mision :

- të plotësojnë formularin elektronik të regjistrimit të kërkesës suaj të azilit, që e bën me dije identitetin tuaj dhe përbërjen e familjes suaj ;
- të marrin takim në sportelin e vetëm dhe t'ju dorëzojnë fletëthirrjen e cila jua bën me dije vendin, ditën dhe orën e saktë kur duhet me patjetër të paraqiteni pranë këtij sporteli. Ky takim mbahet jo më vonë se tre ditë pas paraqitjes suaj pranë kësaj shoqate. Ai mund të shtyhet deri në dhjetë ditë në rast turme të madhe ;
- t'i bëjë fotografitë e identitetit që do t'ju kërkohen në sportelin e vetëm.

Tërësia e dosjes suaj do t'i përcillet sportelit të vetëm në formë të skanuar.

**KUJDES** : Ju duhet detyrimisht të respektoni datën dhe orën që figurojnë mbi fletëthirrje. Në rast vonese, nuk do të mund të pranoheni dhe do t'ju duhet të paraqiteni përsëri pranë një shoqate për pritje fillestare për të caktuar një takim tjetër.

#### ✓ Roli i sportelit të vetëm

Regjistrimi i kërkesës suaj të azilit pranë sportelit të vetëm ndahet në tri etapa.

**Gjatë etapës së parë**, një punonjës i prefekturës e bën të vlefshme tërësinë e informacioneve të përcjella deri te sporteli i vetëm nga ana e organizatës për praninë paraprak.

Ky punonjës ju merr gjithashtu shënjat e 10 gishtërinjve<sup>1</sup> dhe bën një intervistë që shëben për ripërshkrimin e rrugëtimit tuaj nga vendi i juaj i prejardhjes, me qëllim përcaktimin e vendit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit (shih 2.1. Përcaktimi i shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit).

Në fund të kësaj etape, informoheni mbi procedurën që do të zbatohet gjatë shqyrtimit të kërkesës suaj të azilit.

---

<sup>1</sup> E domosdoshme nga mosha 14 vjeçe.



Nëse kërkesa juaj e azilit mund të jetë në përgjegjësinë e një vendi tjetër, atëherë zbatohet procedura e quajtur « Dublin III » (shih 2.1. Përcaktimi i shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit). Nëse kërkesa juaj e azilit është në përgjegjësinë e Francës, është OFPRA ajo që është kompetente për ta shqyrtuar, me procedurë normale apo të përshpejtuar. Në procedurë të përshpejtuar, afatet e shqyrtimit nga OFPRA në përgjithësi janë pesëmbëdhjetë ditë, por garancitë janë të njëjta për të dyja procedurat.

**Kërkesa juaj kalohet automatikisht në procedurë të përshpejtuar**, që nga sporteli unik, në dy raste :

- kur keni shtetësinë e një vendi të prejardhjes i cili është i cilësuar i sigurt (lista e këtyre vendeve është e disponueshme në prefekturë ose në internet, në sitin e OFPRA-s) ;
- kur të keni bërë një kërkesë të parë të azilit e cila të ketë qenë përfundimisht e mbyllur dhe ju kërkon rihapjen e saj.

**Kërkesa juaj mund të kalohet në procedurë të përshpejtuar**, që nga sporteli unik, në rastet e mëposhtme :

- nëse refuzoni t'i jepni shenjat e gishtërinjve ;
- nëse mundoheni të ngatërroni autoritetet duke paraqitur dokumenta të rreme, duke dhënë indikacione të pavërteta ose duke fshehur informacione ;
- nëse keni paraqitur më tepër kërkesa me identitete të ndryshme ;
- nëse jeni vonuar me kërkesën tuaj të azilit pas hyrjes në Francë (më shumë se 120 ditë) ;
- nëse e kërkon azilin me të vetmin qëllim për të shmangur një masë dëbimi ndaj jush ;
- nëse prania juaj paraqet kërcënim të rëndë për rendin publik, sigurinë publike apo sigurinë e shtetit.

Pa regjistrimit, ju lëshohet një dëshmi e kërkesës së azilit, e vlefshme një muaj. Brenda këtij afati, ju do të duhet të dërgoni formularin e plotësuar të kërkesës suaj të azilit pranë OFPRA-s (shih 3-1).

**Gjatë etapës së dytë**, një punonjës i OFII bën vlerësimin e gjendjes suaj personale me anë të një pyetësori (shih 4.1. Shoqërimi i azilkërkuesit). Ky vlerësim nuk mund të ketë të bëjë me motivet e kërkesës suaj të azilit që do të përmenden para OFPRA-s.

Nëse akoma nuk jeni të strehuar dhe kërkon marrje përsipër, i njëjti punonjës kërkon një vendstrehim drejt të cilit do t'ju drejtojë (shih 4.2. Strehimi i azilkërkuesit).

Së fundmi, ai i hap rrugën të drejtës suaj për ndihmën për azilkërkues (shih 5.1. Ndihma e azilkërkuesit).

#### ✓ **Shoqërimi pas kalimit në sportelin e vetëm**

Pas kalimit në sportelin e vetëm, do t'ju propozohet një shoqërim në kuadrin e një vendstrehimi, nëse bëhet fjalë për një qendër pritjeje për azilkërkues (CADA), ose për një vendstrehim urgjent dhe të qëndrueshëm (jo në hotel).

Nëse nuk jeni të strehuar në një vend të tillë, shoqërimi juaj do të bëhet nga një strukturë e specializuar drejt të cilës do t'ju orientojë OFII.

Ky shoqërim nënkupton sidomos caktimin e një adrese dhe ndihmën në krijimin e dosjes së kërkesës së azilit që dueht të dorëzoni në OFPRA.

#### ■ **Kushtet materiale të pritjes**

Gjatë takimit tuaj për regjistrimin e kërkesës suaj të azilit pranë sportelit të vetëm, OFII do t'ju propozojë një ofertë për t'ju marrë përsipër. Duke e pranuar këtë ofertë, do të mund të përfitoni nga kushte materiale specifike të pritjes, të vlefshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurës suaj të azilit.



Kushtet materiale të pritjes ngërthejnë :

- strehim në një qendër pritjeje për azilkërkues (CADA) ose në një qendër strehimi urgjent, për ju dhe, në rast nevojë, për anëtarët e familjes suaj ;
- shoqërim në përçapjet tuaja administrative dhe sociale me qëllim sigurimin e ndjekjes së dosjes suaj të azilkërkimit si dhe qasjen në të drejtat sociale që do t'ju njihen ;
- ndihmë financiare mujore (ndihmën për azilkërkues - ADA), shuma e së cilës do t'i përshtatet përbërjes së familjes suaj.

Nëse e refuzoni ofertën e marrjes përsipër, e humbisni të drejtën e përfitimit nga tërësia e kushteve materiale të pritjes.

Marrja përsipër që ju propozohet është e lidhur me statusin e azilkërkuesit. Ju nuk do të keni pra më drejtë të përfitoni nga ajo që nga momenti i marrjes së një vendimi përfundimtar lidhur me kërkesën tuaj të azilit. Nëse ndonjë vend tjetër është përgjegjës për trajtimin e kërkesës suaj të azilit, do të mund të përfitoni nga kushtet materiale të pritjes deri në transfertën drejt këtij vendi.

### ■ Marrja parasysh e prekshmërisë nga ana e sportelit të vetëm

Gjatë kalimit tuaj para sportelit të vetëm dhe pas regjistrimit të kërkesës suaj të azilit, një punonjësi i OFII do t'ju pranojë personalisht me qëllim të vlerësimit të nevojave tua të veçanta për sa i përket pritjes.

Biseda do të jetë e fshehtë.

Një listë me pyetje do t'ju parashtrohet për të përcaktuar nëse keni nevojë të përfitoni nga kushte pritjeje specifike. Nëse gjendja juaj e kërkon një gjë të tillë, punonjësi i OFII do t'i marrë parasysh këto elemente për t'ju orientuar drejt një vendstrehimi të përshtatshëm.

Jeni të lirë të pranoni ose të refuzoni t'i përgjigjeni pyetësorit. Në rast refuzimi, administrata nuk do të mund të mbajë përgjegjësi për orientimin drejt një vendstrehimi që nuk do të ishte i përshtatshëm për nevojat tuaja ose për mosbërjen me dije të situatës suaj OFPRA-s.

Nëse vini në Francë me dosje mjekësore, punonjësi i OFII do të përcjellë dosjen tuaj me zarf të mbyllur mjekut të OFII i cili do të vendosë nëse situata juaj kërkon një përshtatje të kushteve të pritjes. Nëse jeni të pamundur, do të drejtoheni drejt ndonjë strukture shëndetësore ose drejt shërbimit të urgjencës së spitalit më të afërt.

Nëse punonjësi i OFII zbulon ndonjë situatë prekshmërie, ai mund, me pëlqimin tuaj, të lajmërojë OFPRA-n. Ky informacion ka për qëllim t'i përshtasë, po qe e nevojshme, kushtet e hetimit të kërkesës suaj të azilit nga ana e OFPRA-s (për shembull, përshtatjen e qasjes për personat e handicapuara, ose vënia në dispozicion e një përkthyesi në gjuhën e shenjave). Është OFPRA ajo që i vlerëson përshtatjet e nevojshme.

Nevojat që kanë të bëjnë me gjendjen e prekshmërisë do të mund të merren parasysh gjatë gjithë shqyrtimit të kërkesës suaj të azilit nga ana e punonjësve socialë në strukturat e strehimit ose nga shoqatat që kanë përsipër shoqërimin tuaj në përçapjet administrative dhe sociale.

## 4.2. Strehimi i azilkërkuesit

### ■ Vendet e strehimit

Ekzistojnë afër 50 000 vende strehimi të dedikuara për azilkërkuesit, qoftë në CADA, qoftë në strukturë strehimi të urgjencës, të shpërndara mbi të gjithë territorin francez. Llojet e strehimit të urgjencës janë të ndryshme : banesa, qendra kolektive ose dhoma hoteli. Në të gjitha këto vende mund të hyjnë vetëm azilkërkuesit dhe familjeve të tyre të drejtpërdrejta.



Për të përfituar nga këto lloje strehimi, duhet të jeni të pajisur me dëshmi të azilkërkuesit. Personat, kërkesa e të cilave është në përgjegjësinë e një shteti tjetër të Bashkimit europian, nuk kanë qasje në strehimin që e ofron CADA.

Në CADA dhe në strehim urgjent, është e mundur të keni nevojë t'i ndani disa hapësira (kuzhina, banjo, tualet) me persona ose familje të tjera.

Në CADA dhe në një pjesë të vendeve të strehimit të urgjencës, do të përfitoni nga një përcjellje administrative (shoqërim gjatë procedurës së azilkërkimit), dhe të një përcjelljeje sociale (qasje në shërbimet shëndetësore, shkollimin e fëmijëve, etj.). Ky mekanizëm financohet dhe koordinohet nga shteti. Vendet e strehimit, në shumicën e rasteve, janë të administruara nga shoqatat.

### ■ Orientimi drejt strehimit

Kushtet materiale të pritjes, që nënkuptojnë një ofertë strehimi, do t'ju propozohen nga OFII që gjendet brenda sportelit të vetëm ku e keni regjistruar kërkesën tuaj të azilit. Nëse e refuzoni këtë ofertë të marrjes përsipër, ju nuk do të mund të përfitoni nga ndihma financiare për azilkërkuesit (ADA).

**Nëse keni pranuar ofertën e marrjes përsipër, OFII do t'ju propozojë, në varësi të vendeve të lira të strehimit, një vend në CADA ose një strehim urgjent.** Në mungesë të vendeve të tilla, OFII ju orienton drejt shoqatave që, në pritje të një zgjidhjeje, do të kërkojnë një vend në hotel.

Kërkesa juaj për strehim do të shqyrtohet nga OFII në varësi nga vendet e lira në atë departament, krahinë ose mbi tërësinë e territorit francez.

**Një strehim mund t'ju propozohet jashtë departamentit ose krahinës në të cilën keni dorëzuar kërkesën tuaj të azilit.** Nëse refuzoni këtë propozim, nuk do të mund të përfitoni më nga ndihma financiare ADA dhe nuk do t'ju bëhet më asnjë propozim tjetër strehimi në vende të dedikuara për azilkërkuesit.

Nëse asnjë zgjidhje nuk ju është propozuar, keni mundësinë që çdo ditë dhe nga cilado kabinë telefonike, të merrni numrin **115, që është falas.** Duke e treguar emrin tuaj dhe vendndodhjen, do të merreni përsipër gjatë natës dhe do të strehoni në një qendër pritjeje të urgjencës. Ky numër është shpesh i zënë. Mos ngurroni të telefononi përsëri.

Megjithatë, nëse keni refuzuar një vend strehimi nga OFII, 115-ta do t'ju pranojë vetëm nëse jeni në gjendje shqetësimi mjekësor, psiqik apo social të veçantë.

### ■ Largimi nga vendi i strehimit

Nëse jeni të pranuar në një vend strehimi të dedikuar për azilkërkues, ju do të përfitoni nga kjo e drejtë gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurës suaj të azilkërkimit, duke e futur këtu, në rast nevoje, edhe periudhën e ankimit pranë CNDA.


Nëse vendimi përfundimtar i OFPRA ose i CNDA është pozitiv, ju duhet të lini qendrën në një afat prej tre muajsh, që mund të përtërihet një herë. Nëse vendimi është negativ, do të duhet që detyrimisht të lini qendrën në një afat prej një muaji.

Në qoftë se qëndroni në këtë vend strehimi përtej këtij afati, prefekti i departamentit do të mund t'ju paralajmërojë të lironi këtë hapësirë. Dhe, në rast se ju nuk do ta linit edhe pas kësaj strukturën,



prefekti mund t'i drejtohet gjykatësit administrativ me procedurë të shkurtër që ai t'ju urdhërojë t'i lironi hapësirat.

Nëse vendimi përfundimtar i OFPRA-s dhe CNDA është negativ, ju mund të përfitoni nga ndihma për kthimin vullnetar (shih 6.2. Ndihma gjatë kthimit në vendin e prejardhjes).



## 5. Të drejtat e azilkërkuesve

### 5.1. Ndhimja financiare për azilkërkues (ADA)

Ndhimja financiare për azilkërkues (ADA) është krijuar me ligjin e 29 korrikut 2015 që ka të bëjë me reformën e të drejtës së azilit. Ajo e ka zëvendësuar, duke filluar nga 1 nëntori 2015, ndihmën financiare të përkohshme të pritjes (ATA) dhe ndihmën financiare mujore të jetesës (AMS).

OFII merr përsipër administrimin e kësaj ndihme e cila paguhet nga Agjencia e shërbimeve dhe e pagesave.

Ajo jepet gjatë periudhës së hetimit të kërkesës së azilit ose deri në realizimin e transfertës drejt një shteti që është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së azilit, si dhe të huajve që përfitojnë nga mbortja e përkohshme dhe atyre që kanë marrë leje qëndrimi të përkohshme në zbatim të nenit L. 316-1 të CESEDA (viktima të trafikimit ose të proksenetizmit).

#### ■ Kushtet për të përfituar nga ndihma

Për të përfituar nga ndihma financiare për azilkërkues, ju duhet :

1. të jeni të pajisur me dëshmi të kërkesës së azilit ose me leje qëndrimi që ju është lëshuar në cilësinë e :

- a) azilkërkuesit që ka bërë kërkesën e vet në Francë (neni L.741-1 i CESEDA),
- b) azilkërkuesit që bie nën procedurën « Dublin III » (neni L.742-1 i CESEDA),
- c) përfituesit të mbrojtjes së përkohshme (neni L.743-1 i CESEDA),
- d) të huajit, viktimë e trafikimit njerëzor ose e proksenetizmit (neni L.316-1 i CESEDA) ;

2. të keni moshën 18 vjeç ;

3. nëse jeni azilkërkues, t'i keni pranuar kushtet materiale të pritjes të propozuara nga OFII.

#### ■ Hartimi i kërkesës

Nëse jeni azilkërkues, e drejta e ndihmës financiare për azilkërkues ju jepet pas regjistrimit të kërkesës suaj pranë sportelit të vetëm, dhe me kusht që të pranoni ofertën e marrjes përsipër që do t'ju paraqitet nga OFII.

Derdhja e ndihmës financiare fillon vetëm pas dorëzimit të kërkesës suaj në OFPRA, në një afat prej më së shumti 21 ditësh pas regjistrimit të kërkesës suaj.

Nëse bini nën kategoritë e përmendura në pikën 1. c) dhe d), kërkesa juaj duhet parashtruar pranë drejtorise territoriale të OFII nën kompetencën e së cilës është adresa juaj (cf. lista e drejtorive territoriale të OFII në shtojcë).

Aty ju mund të tërhiqni një formular. Pasi ta keni plotësuar, duhet ta ktheni në OFII dhe t'i bashkangjisni dëshmitë që kanë të bëjnë me lejen tuaj të qëndrimit, përbërjen e familjes suaj dhe të ardhurat tuaja.



### ■ Shuma e ndihmës financiare

Për të përfituar nga ndihma financiare e azilkërkuesit, ju duhet të dëshmoni se të ardhurat tuaja mujore janë më të ulëta se shuma e pagesës së solidaritetit aktiv (RSA).

Shuma e ndihmës financiare llogaritet në bazë të një tablele që merr parasysh përbërjen tuaj familjare, të ardhurat tuaja dhe llojin e strehimit.

### ■ Derdhja e pagesës

Ndihma financiare e azilkërkuesit do t'ju jepet deri në momentin e një vendimi përfundimtar mbi kërkesën tuaj të azilit, që do të thotë deri në vendimin e njoftuar nga OFPRA, dhe i cili të mos jetë kontestuar në një afat prej një muaji (neni L.731-2 i CESEDA) ose, në rast ankimi, në momentin e vendimit të njoftuar nga CNDA.

Ndihma financiare ndërpritet në fund të muajit të ardhshëm pas atij kur ju është njoftuar vendimi përfundimtar lidhur me kërkesën e azilit, ose duke filluar nga transferta (ose ikja) e azilkërkuesit që është në procedurën « Dublin III ».

Nëse ju takon mbrojtja e përkohshme, ndihma financiare ju jepet gjatë kohëzgjatjes së mbrojtjes.

Nëse jeni i huaj, viktimë e trafikimit njerëzor ose e proksenetizmit (neni L. 316-1 i kodit të sipërpërmendur), ndihma financiare paguhet përgjatë 12 muajsh duke filluar nga kërkesa, dhe mund të përtërihet gjatë kohëzgjatjes së vlefshmërisë së lejes suaj të qëndrimit.

Ndihma financiare mund :

- të pezullohet nëse, pa arsye legjitime, keni lënë vendin tuaj të strehimit, nuk keni respektuar detyrimin tuaj të paraqiteni pranë autoriteteve, nuk u jeni përgjigjur kërkesave të dhënies së informacioneve ose nuk jeni paraqitur në takimet personale që kanë të bëjnë me procedurën e azilit ;
- të tërhiqet, nëse keni keni fshehur të ardhurat tuaja ose keni dhënë informata të rreme lidhur me gjendjen tuaj familjare, nëse keni pasur sjellje të dhunshme apo keni cënuar rëndë rregulloren e vendit tuaj të strehimit ;
- të refuzohet, nëse keni paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e kërkesës suaj të azilit ose nëse pa arsye legjitime keni kërkuar ndihmën me shumë vonesë.

### ■ Ankesa

Ju duhet detyrimisht të njoftoni OFII mbi çdo ndryshim adrese që mund të ketë ndodhur në rastin tuaj, qoftë për sa i përket të drejtës suaj të qëndrimit, gjendjes suaj familjare, të ardhurave tuaja, apo vendit tuaj të punës.

Në rast kontestimi të një vendimi që ka të bëjë me ADA, të marrë nga OFII, ju takon juve të parashtroni ankesë vullnetare pranë OFII, duke qenë se gjykata administrative, nga ana e saj, është kompetente në rast ankesë për çështjet me sherr.

## 5.2. Qasja në shkollim

Qasja në sistemin e shkollimit për familjet e azilkërkuesve është e njëjtë me atë të qytetarëve francezë.

Në përputhje me ligjin e edukimit (neni L. 111-2) « Çdo fëmijë ka të drejtë të ketë një formim shkollor i cili, duke e plotësuar veprimtarinë e familjes, jep kontribut në edukimin e tij ».

Ai sjell ndërmend faktin që : « Shkollimi është i detyrueshëm për fëmijët e të dyja gjinive, francezë dhe të huaj, brenda moshës 6 deri 16 vjeç » (neni L. 131-1 i ligjit të sipërpërmendur).



Regjistrimi në shkollën fillore bëhet pranë bashkisë. Ju duhet t'i paraqisni dokumentat që dëshmojnë bijësinë e fëmijës suaj, vendbanimin tuaj dhe faktin që fëmija i ka pranuar të gjitha vaksinat e moshës së vet.

Regjistrimi në një institucion të shkollimit të mesëm (kolegj apo gjimnaz) bëhet drejtpërsëdrejti pranë institucionit më të afërt nga vendbanimi juaj.

Struktura të cilës i është ngarkuar shoqërimi juaj administrativ dhe social, qoftë struktura që ka përsipër strehimin tuaj, qoftë ndonjë shoqatë që ka nënshkruaj marrëveshje me OFIL, mund t'ju japë ndihmë në përmbushjen e këtyre përçapjeve.

### 5.3. Qasja në shërbimet shëndetësore

#### ■ Shërbimet shëndetësore të urgjencës

Në pritje të përfitimit nga mbrojtja sociale e ofruar për azilkërkuesit në kuadrin e mbrojtjes shëndetësore universale (CMU), ju mund të drejtoheni pranë kujdestarive të shërbimeve shëndetësore (PASS) që gjenden nëpër spitale. Ju do të merreni nën përkujdesje nga mjekët dhe do t'ju jepen barna falas.

Përveç kësaj, disa shoqata propozojnë kujdestari të shërbimeve stomatologjike, oftalmologjike ose psikologjike, pa qenë nevoja të keni sigurim shëndetësor.

Në varësi nga vendi juaj i stehimit, brenda shërbimeve administrative të departamentit, shpesh gjenden shërbime të mbrojtjes së nënave dhe fëmijëve (PMI) që kanë marrë përsipër ndjekjen e rregullt të fëmijëve dhe vaksinimit të tyre, dhe qendra planifikimi dhe edukimi familjar, të dedikuara për gratë (informacione mbi kontracepcionin dhe ndjekjen e shtatëzanisë). Ju mund të përfitoni nga këto shërbime madje edhe para se të përfitoni nga CMU.

#### ■ Mbrojtja shëndetësore universale (CMU)

Në cilësinë e azilkërkuesit, ju mund të përfitoni nga mbrojtja shëndetësore universale (CMU), themelore dhe plotësuese, që nga regjistrimi i kërkesës suaj të azilit, pasi të keni paraqitur vërtetimin e kërkesës së azilit të marrë pranë sportelit të vetëm, të shoqëruar me një dëshmi vendbanimi.

Ajo ju mundëson të marrjen përsipër falas për të gjitha shpenzimet mjekësore dhe spitalore për ju, bashkëshorten/bashkëshortin tuaj dhe për fëmijët.

Për të përfituar nga CMU, ju duhet të bëni kërkesë pranë Arkës themelore të sigurimit shëndetësor (CPAM) të vendbanimit tuaj. Në këtë përçapje ju mund t'ju ndihmoheni nga struktura në të cilën jeni vendosur ose nga struktura që ka përsipër shoqërimin tuaj gjatë shqyrtimit të kërkesës suaj të azilit, apo edhe nga disa shoqata, nga një qendër komunale ose ndërkomunale e veprimtarisë sociale ose nga shërbimi social i një spitali.

Të drejtat për të pasur CMU themelore bëhen efektive menjëherë dhe janë të përhershme. Për sa i përket CMU plotësuese, ato janë të vlefshme një vit. Është pra e nevojshme të kërkonit çdo vit përfitjen e të drejtave për CMU plotësuese.

CPAM mund t'ju kërkojë më tutje dokumenta plotësuese për t'ju dhënë një numër përfundimtar dhe për të lëshuar një kartë shëndetësore elektronike të quajtur « karta Vitale ».

### 5.4. Qasja në tregun e punës





Si azilkërkues, ju mund të jeni të autorizuar të punoni kur OFPRA, për arsye që nuk kanë të bëjnë me ju, nuk ka vendosur mbi kërkesën tuaj të azilit në një afat prej nëntë muajsh nga parashtrimi i kërkesës suaj të azilit (neni L. 744-11 i CESEDA).

Në këtë rast, dhe pas verifikimit nëse këto dy kushte janë plotësuar, ju do të mundeni, pasi të keni paraqitur kërkesën e autorizimit për punë të hartuar nga punëdhënësi juaj i ardhshëm, të kërkonti një autorizim për punë në prefekturën e departamentit të vendbanimit tuaj.

Vendimi që ka të bëjë me kërkesën për autorizim për punë merret nga prefekti dhe i bëhet me dije punëdhënësit tuaj të ardhshëm dhe juve gjithashtu.

Nëse pajtohet, prefekti do të dërgojë autorizimin për punë që ka të bëjë me kontrata pune më të gjata se tre muaj ose mbi kontrata pune sezonale në OFII.

Ky autorizim megjithatë mund t'ju refuzohet, sidomos në varësi nga situata e punësimit në krahinë ose sektorin në fjalë, përveç nëse konkurrioni për një punë që figuron në njërin nga listat e profesioneve, rekrutimi i të cilave karakterizohet me vështirësi të shprehura.

Nëse jeni të pajisur me autorizim të përkohshëm për punë dhe në rast të ndërprerjes së kontratës për një arsye që nuk ka të bëjë me ju, ose pasi të ketë përfunduar kontrata me kohë të caktuar ose kontrata për zëvendësim, ju mund të kërkonti të jeni të regjistruar si punëkërkues, pranë Entit të punësimit (Pôle emploi).

Se fundmi, nëse jeni të pranuar në tregun e punës, ju do të mund gjithashtu të përfitoni, në kushtet e parapara nga ligji i punës, nga veprimtari të formimit profesional.



## 6. Pasojat e refuzimit të kërkesës së azilit mbi të drejtën e qëndrimit në territorin francez

---

### 6.1. Vendimi i refuzimit nga OFPRA ose nga CNDA

Nëse OFPRA e ka hedhur poshtë kërkesën tuaj të azilit dhe nëse nuk keni parashtruar ankesë, ose nëse CNDA e ka hedhur poshtë ankesën tuaj, ju e humbisni të drejtën e qëndrimit në territorin francez. Atëherë duhet të lini Francën, madje edhe nëse keni parashtruar kërkesë për anulim vendimi para Këshillit të shtetit, kundrejt vendimit të CNDA.

### 6.2. Ndhimja gjatë kthimit në vendin e prejardhjes

Prefektura do t'ju njoftojë një vendim mbi refuzimit e qëndrimit, të shoqëruar me një detyrim për të lënë territorin francez (OQTF). Ky vendim do të saktësojë afatin nga i cili do të përfitoni, në atë rast, për të lënë vullnetarisht Francën (në parim, një muaj). Brenda këtij afati, në disa raste, ju mund të kërkonit të përfitoni nga një ndihmë gjatë kthimit në vendin tuaj të prejardhjes. Në atë rast duhet të kontaktoni OFII.

#### ✓ Mekanizmi i ndihmës gjatë kthimit

Ndhimja gjatë kthimit ka për qëllim t'i lehtësojë largimet nga Franca të të huajve që duan të kthehen në vendin e tyre.

Duke pasur për qëllim përkrahjen e një kthimi me dinjitet, ndihmat e marra përsipër nga OFII ngërthejnë :

- një ndihmë administrative dhe materiale në përgatitjen e udhëtimit drejt vendit tuaj të kthimit e që parashihet organizimin material të nisjes vullnetare të përfituesit dhe të familjes së tij :
  - rezervimin e biletave me linjë ajrore ;
  - ndihmën për pajisjen me dokumenta udhëtimi ;
  - transportin nga vendbanimi në Francë deri te aeroporti i nisjes që gjendet po në Francë ;
  - pritje dhe ndihmë gjatë formaliteteve të nisjes nga aeroporti.
- marrjen përsipër të shpenzimeve të transportit nga vendi i nisjes në Francë deri në mbërritjen në vendin e tuaj të kthimit, duke futur këtu edhe transportin e valixheve deri në sasinë e kufizuar sipas vendit të kthimit ;
- një ndihmë financiare që i paguhet të huajit një herë të vetme, në momentin e nisjes.

#### ✓ Mekanizmi i ndihmës për ripërfshirje

Në plotësim ose pavarësisht nga ndihmat e lartpërmendura për kthim, ndihma për ripërfshirjen ekonomike dhe sociale mund t'i propozohen të huajve që janë kthyer në vendin e tyre.

Këto ndihma mund t'u paguhet, me disa kushte, të huajve të cilëve u është refuzuar e drejta e azilit dhe familjeve të tyre.



Ndihmat për ripërfshirje artikuloohen rreth një mekanizmi me tre nivele. Në varësi nga situata dhe nevojat e përfituesve, këto ndihma mund të kombinoohen mes veti, në varësi nga profili i përfituesve :

- një ndihmë ripërfshirjeje sociale në mbërritje (niveli 1) ;

Një ndihmë urgjente, materiale dhe financiare, që mund të ketë të bëjë me përmirësimin e banesës ose një ndihmë strehimi gjatë një periudhe të kufizuar, marrjen përsipër të shpenzimeve shëndetësore, të shkollimit të fëmijëve dhe mjeteve shkollore.

Ajo mund gjithashtu të përfshijë një shoqërim social, gjatë një kohe të caktuar, për shembull në formë të një bilanci të nevojave të familjes.

- një ndihmë ripërfshirjeje në punë (niveli 2) ;

Ajo mund të përbëhet nga :

- një ndihmë për gjetje pune në vendin e kthimit ;
- një ndihmë gjatë kërkimit të punës ;
- ndihma për formim profesional.

- një ndihmë ripërfshirjeje me të krijimit të një ndërmarrjeje (niveli 3).

### 6.3. Kthimi i detyruar në vendin e prejardhjes

Nëse keni pasur në dispozicion një afat të nisjes vullnetare prej një muaji dhe nëse nuk e keni lënë territorin, as nuk keni kërkuar ndihmë për kthimin vullnetar nga OFII, as nuk keni parashtruar ankesë kundër detyrimit për të lënë territorin francez (OQTF), ju gjendeni në situatë të parregullt mbi territorin francez. Në atë rast, ju do të mund të shoqëroheni në kufi nga policia. Kjo masë dëbimi mund të shoqërohet me vendosje në një qendër mbajtjeje administrative, me qëllim që të bëhet dëbimi në vendin tuaj.

Nëse ndaj jush është shqiptuar një detyrim për lënien e territorit (OQTF) pa afat nisjeje vullnetare, ju jeni në situatë të parregullt duke filluar nga njoftimi i vendimit dhe i ekspozoheni rrezikut të shoqërimit në kufi.

OQTF mund të kontestohet para gjykatës administrative në një afat prej një muaji pas njoftimit të saj (48 orë nëse OQTF nuk parasheh afat largimi). Për të parashtruar këtë ankesë, ju duhet të kërkonit të përfitoni nga një ndihmë juridike pranë një gjykate administrative kompetente. Kjo e fundit ka në dispozicion tre muaj për të vendosur. Megjithatë, nëse jeni të venosur në mbajtje administrative, gjykata administrative do të shpreht brenda 72 orësh.

Ankesa kundër OQTF është pezulluese : ju nuk mund të largoheni gjatë afatit që keni në dispozicion për të parashtruar ankesë dhe, nëse i jeni drejtuar gjykatës, para se ajo të jetë shprehur.

Ndaj jush gjithashtu mund të merret një vendimi prefektoral i shoqërimit në kufi (APRF), i cili mund të kontestohet në një afat prej 48 orësh para gjykatës administrative. Vendimi i gjykatës në atë rast merret brenda 72 orësh. Kjo ankesë është gjithashtu pezulluese.



## 7. Të drejtat e përfituesve nga mbrojtja

---

Nëse ju është njohur statusi i refugjatit, keni përfituar të drejtën e mbrojtjes së dorës së dytë ose statusin e personit pa shtetësi, ju jeni tanimë nën mbrojtjen e autoriteteve franceze.

Nëse jeni refugjat ose përfitues i mbrojtjes së dorës së dytë, ju nuk mund më t'i drejtoheni autoriteteve të vendit tuaj të prejardhjes, dhe as të ktheheni atje për shkak të frikës që ndieni.

Është OFPRA ajo që siguron mbrojtjen tuaj administrative dhe juridike, që do të thotë se është ky institucion që ju jep dokumentat e gjendjes civile ose dokumentat administrative, pasi të ketë ripërcaktuar gjendjen tuaj civile.

### 7.1. Qëndrimi në Francë

**Si refugjat**, ju keni të drejtë të keni një kartë rezidenti për 10 vjet, që përtërihet automatikisht, që ju autorizon të lëvizni lirshëm mbi territorin francez.

Sapo të merrni letrën që jua njih cilësinë e refugjatit, ju duhet t'i drejtoheni prefekturës së vendbanimit tuaj. Brenda një afati prej tetë ditësh nga kërkesa juaj për leje qëndrimi, prefektura do t'ju dorëzojë një vërtetim të parë (récépissé), të vlefshëm gjashtë muaj dhe që mund të përtërihet, e që bart mbishkrimin : « i njohur si refugjat ». Ky vërtetim ju jep të drejtën të ushtroni profesionin që dëshironi. Ai do të përtërihet deri në lëshimin e kartës së rezidentit.

**Si përfitues i mbrojtjes së dorës së dytë**, ju keni të drejtë të keni një leje qëndrimi të përkohshme për një vit, që mund të përtërihet më tutje për dy vjet, dhe që ju autorizon të lëvizni lirshëm në territorin francez.

Sapo të merrni letrën që jua njih këtë mbrojtje, ju duhet t'i drejtoheni prefekturës së vendbanimit tuaj. Brenda një afati prej tetë ditësh nga kërkesa juaj për leje qëndrimi, prefektura do t'ju dorëzojë një vërtetim të parë (récépissé), të vlefshëm gjashtë muaj dhe që mund të përtërihet, e që bart mbishkrimin : « ka fituar të drejtën e mbrojtjes së dorës së dytë ». Ky vërtetim ju jep të drejtën të ushtroni profesionin që dëshironi.

Ky dokument do të përtërihet deri në dhënien përfundimtare të lejes suaj të qëndrimit. Para se kësaj të fundit t'i kalojë afati, do të duhet t'i drejtoheni prefekturës për përtëritjen e saj.

Leja juaj e qëndrimit do të mund, me disa kushte, t'ju tërhiqet nëse OFPRA ose CNDA ndërpret marrjen tuaj në mbrojtje ose nëse ju personalisht hiqni dorë nga ajo.

**Si person pa shtetësi**, ju keni të drejtë të keni një leje qëndrimi të përkohshme për një vit, që mund të përtërihet më tutje për dy vjet, dhe që ju autorizon të lëvizni lirshëm në territorin francez.

